



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1315/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Flora Sadiku, në cilësinë e Kandidates për Anëtare të Kuvendit Komunal në Kllkotë nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), paraqitur kundër shpalljes së rezultateve përfundimtare nga QNR-KQZ, për Zgjedhjet Lokale në seancën e panelit të mbajtur me 27.12.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Flora Sadiku, në cilësinë e Kandidates për Anëtare të Kuvendit Komunal në Kllkotë nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK).

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 24.12.2013 nga Flora Sadiku ku ka pretenduar se në Qendrën e Vendvotimit (QV) 3704D/01D, ka pasur prishje të fletëvotimeve sepse sipas saj në këtë QV janë gjetur 40 fletëvotime të pavlefshme me këtë rast pretendon se është dëmtuar si kandidate dhe si subjekt politik.

Parashtruesja e ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë dëshmi si.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore të Kandidates për Anëtare të Kuvendit Komunal Flora Sadiku, janë të pa argumentuara në fakte dhe dëshmi konkrete pasi që ankesës në fjalë nuk i ka bashkangjitur asnjë dëshmi bindëse si provë për tu vërtetuar për shkeljet e supozuar andaj ankesa vlerësohet si e pa bazë, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 1315/2013 më datën 27.12.2013.

Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha

**Këshillë Juridike:** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.

